



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 16 nëntor 2011, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**P R O C E S V E R B A L**  
**I M B L E D H J E S S Ë K O M I S I O N I T P Ë R S H Ë N D E T Ë S I, P U N Ë**  
**D H E M I R Ë Q E N I E S O C I A L E**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Gëzim Kelmendi, Sasha Gjokiq, Nazane Breca dhe Aurora Bakalli

**Të pranishëm:** Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Ervin Ibrahimit- UNDP

**Mbledhjen e kryesoi:** Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.10.2011**
- 3. Shqyrtimi i Propozim Planit Veprimit të Kuvendit për integritet evropian ;**
- 4. Të ndryshme**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1.Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i procesverbalit të datës 26.10. 2011**

Deputetja Salihe Mustafa, kërkoi të bëhet plotësimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar dhe diskutimi i saj te jetë me gjithëpërfshirës.

*Pas kësaj, kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e datës 26 tetor 2011, me vërejtjen e deputetes Salihe Mustafa.*

### **3. Shqyrtimi i Propozim Planit Veprimit të Kuvendit për integritet evropiane**

**Fikrim Damka-** Duke e hapur diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës, tha se Komisioni për integritet evropiane ka përgatitur një propozim- plan të veprimit të Kuvendit për integritet evropiane për vitin 2012. Ky plan në disa pika lidhet me fushën e veprimtarisë së komisionit tonë. Hap diskutimin lidhur me plotësimin e pikave të propozuara:

**Time Kadriaj-** Propozoi që pika P53, nga plani i veprimit të jetë në ndonjë komision tjetër, më konkretisht në Komisionin për arsim dhe Komisionin për të drejtat e njeriut.

**Flora Brovina-** diskutoj për pikën P141, që ka të bëjë me shëndetin e komunitetit RAE, dhe tha se edhe Komisioni ynë duhet të informohet për problemet shëndetësore të këtij komuniteti. Çështja e integritetit shëndetësor mbetet problematike. Përveq në pjesën veriore të Mitrovicës, probleme të ngjashme ky komunitet ka edhe në Fushë Kosovë.

**Aurora Bakalli-** Tha se në Raportin e progresit një pjesë mjaft të madhe e zë edhe çështjet shëndetësore e komunitetit RAE. Kujtoj se kjo pjesë na takon neve si komision.

*Pas diskutimeve, Komisioni përkrah miratimin e Planit veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropiane për vitin 2012.*

*Komisioni gjithashtu propozoi që në Propozim – Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropiane për vitin 2012, në pikën P53, Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale të mos jetë i përfshirë , por të jetë Komisioni për Arsim, dhe në pikën P141, Komisioni për Shëndetësi të jetë si Komisioni i dytë.*

### **4. Të ndryshme**

**Fikrim Damka-** Duke diskutuar për Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, tha se për këtë projektligj kemi pasur takime me Bankën Botërore, FMN, kryeministrin, ministrin Rashiq, ministrin e financave. Ju i keni marrë vërejtjet e FMN-së lidhur me këtë Projektligj. Mendoj se duhet t'u përmbahemi rekomandimeve të FMN-së, në mënyrë që projektligji të mos tërhiqet. Edhe FMN edhe ministri i financave janë kundër amendamenteve të propozuara nga komisioni ynë.

**Salihe Mustafa-** Tha se pas takimeve që kemi patur më herët, unë në mbledhjen e kaluar e ndërrova qëndrimin lidhur me këto amendamente dhe tashmë po shihet se jemi në pikën e njëjtë. Ndonëse ne u patëm dakorduar që si Komision të shkojmë në takimin e ministrisë me përfaqësuesit e FMN-së, unë shkova e vetme atje dhe u mundova t'i mbrojtë amendamentet e komisionit.

**Flora Brovina-** E informoi Komisionin se Qeveria ka marrë vendim që të formohet komisioni për verifikimin e statusit të veteranëve dhe të burgosurve. FMN nuk kundërshton përfitimet, por dëshiron të dijë numrin e saktë të përfituesve.

**Nazane Breca-** Propozoi që Komisioni t'i takojë veteranët dhe t'u spjegojë për gjendjen në të cilën ndodhen anëtarët e Komisionit.

**Aurora Bakalli-** Shprehu interes të dijë se çka do të bëhet me nenin 25 të Projektligjit.

**Salihe Mustafa-** Qartësoi se FMN ka qëndrim që neni 25 të mbetet ashtu siç është në Projektligj, për shkak të vështirësive eventuale financiare në të ardhmen dhe kontesteve eventuale gjyqësore.

**Bahri Thaqi-** Tha se ne jemi këtu për ta mbrojtur interesin e shtetit tonë. Duke dashur që t'u ndihmojmë këtyre kategorive, ne, se po rrezikojmë të gabojmë në raport me ta. Shteti ynë është i paqëndrueshëm në aspektin financiar. Synimi i FMN-së është që ky projektligj të jetë real, me vlera reale. Qëndrimet e FMN-së dhe BB-së janë dashamirëse. E përkrah idenë që të hartohet një ligj i ri për veteranët dhe të hartohet lista e saktë e veteranëve. Pra, duhet të jemi serioz në raport me veteranët dhe me shtetin e Kosovës. Shumë ligje nuk zbatohen për shkaqe politike. Edhe arsyet, se pse ministria nuk i ka bërë listat e veteranëve, janë politike.

**Gëzim Kelmendi-** Tha se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka qenë neglizhente dhe nuk i ka verifikuar me kohë listat e veteranëve, prandaj për shkak të neglizhencës së ministrisë nuk bën që të dëmtohen veteranët.

**Time Kadriaj-** Deklaroi se me këtë projektligj dhe më këto amendamente ne nuk kemi dashur t'i dëmtojmë as veteranët e as shtetin. Në këtë drejtim, ne kemi lënë hapësirë kohore deri më 2015 për zbatimin e pjesës së projektligjit që ka të bëjë me veteranët. Ministria nuk i ka kryer punët e saj për formimin e komisioneve adekuate për verifikimin e statusit të veteranëve. Ne duhet të takohemi me përfaqësuesit e veteranëve që t'u spjegojmë se problemi nuk është te ne, por neglizhenca e ministrisë na ka sjellë në këtë situatë.

**Flora Brovina-** Tha se ne si Komision, duhet ta monitorojmë punën e dy komisioneve për verifikimin e statusit të veteraneve, që tashmë po formohen me vendim të Qeverisë.

**Fikrim Damka-** Propozoi që të ftohet ministri i shëndetësisë në Komision, për të diskutuar lidhur me buxhetin e paraparë për shëndetësi, për vitin 2012.

**Time Kadriaj-** E quajti injorim të Komisionit nga ana e ministrit të shëndetësisë, faktin e mospritjes në takim nga ana e ministrit për anëtarët e Komisionit, edhe pse Komisioni ka kërkuar takim disa herë për çështjen e ankesave të sindikatës së punëtorëve shëndetësorë, lidhur me parkingun e QKUK-së.

**Aurora Bakalli-** Deklaroi se e ka parashtruar pyetje për ministrin në seancën plenare lidhur me parkingun e QKUK-së dhe konkretisht pse nuk është pyetur sindikata për një gjë të tillë. Me rregulla për partneritetin publiko-privat, para dhënies së kontratës, duhet të bëhet një studim i fizibilitetit, e i cili nuk është bërë në këtë rast.

**Time Kadriaj-** Tha se disa punëtorë të Ministrisë së shëndetësisë pa arsye janë larguar nga puna. KPMK, pas shqyrtimit të ankesave të tyre, ka marr vendim për kthimin e tyre në punë. Çështja e kthimit të tyre në punë po zvarritet nga ministria, edhe pse ajo është e detyruar t'i zbatojë vendimet e KPMK-së.

*Pas diskutimeve të lartcekura, Komisioni vendosi që kryetari i Komisionit të ketë takim me Ministrin e Shëndetësisë për diskutimin e çështjeve të ngritura gjatë mbledhjes.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

**E përqatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Fikrim Damka**